Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Analiza e tregut të grurit dhe miellit në Kosovë

për vitet 2020/2021

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 30, neni 38 par. 1, dhe neni 61 par. 3, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës me datën 05.11.2021 ka autorizuar Departamentin për Mbikëqyrjen e Tregut, të siguroj të dhënat e nevojshme për shqyrtimin paraprak, për konstatimin e gjendjes në tregun relevant (të prodhimit dhe importit) të produktit të miellit dhe grurit për dy vite, 2020 dhe 2021. Situata me pandeminë Covid 19, ka ndikuar në tregjet nacionale dhe globale, nisur nga çmimet, zingjirin e furnizimit, shkallën e inflacionit, me c'rast Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për të kuptuar funksionimin e tregjeve të caktuara, ka filluar monitorimin dhe shqyrtimin paraprak, për të kuptuar transparencën, pjesëmarrësit e tregut, dhe shkallën e përqendrimit të tregjeve.

Për të bërë shqyrtimin paraprak në tregun relevant të grurit dhe miellit , grupi punues ka zhvilluar një sërë takimesh me palët, organet e administratës publike, personat juridik dhe ka bërë hulumtime të ndryshme, për të kuptuar se si funksionon ky treg, dhe për të konstatuar nëse ka interes publik për të filluar procedurën ndaj subjekteve të cilat kanë ndikim të ndjeshëm mbi konkurrencën në tregun përkatës.

Objektivi i monitorimit është mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për prodhimin, blerjen, importin dhe eksportin e miellit dhe grurit (fillimisht prej doganës së Kosovës dhe pastaj përmes pyetësorëve tek operatorët ekonomik), me theks tek perspektiva e strukturës së tregut si dhe për të analizuar tendencat e çmimeve të grurit dhe miellit.

Për nevoja të shqyrtimit paraprak/monitorimit, janë identifikuar dy tregje relevante: tregu i prodhimit dhe i importit.

Tregu Relevant

1.1 Tregu i produktit

Tregu i produktit përcaktohet Gruri si input i produktit final (importi dhe prodhimi) dhe i miellit si produkt final (importi dhe prodhimi)

1.2 Tregu gjeografik

Tregu gjeografik është i tërë territori i Republikës së Kosovës

Përmbajtja

1. Situata e përgjithshme në periudhën Covid - 19 (2020-2021), Inflacioni – Çmimet

1.1 Inflacioni në BE 7

2. Niveli i Inflacionit në Ballkanin Perëndimor 10

2.1 Kosova 11

2.2 Shqipëria 14

2.3 Serbia 15

2.4 Maqedonia 16

2.5 Mali i Zi 17

2.6 Bosnja dhe Hercegovina 18

3. Rendimenti i grurit-Pasqyra globale, si input që ndikon edhe ne territorin e Kosovës 19

4. Sipërfaqja, rendimenti dhe prodhimtaria e grurit për vitet 2015-2021 në Kosovë: 22

5. Importi, struktura, vendi i origjinës, çmimi 24

6. Shkalla e përqendrimit te tregut te importit të grurit dhe miellit 39

7. Struktura e tregut te grurit prodhimi vendor, importi, eksporti 40

8. Transparenca e tregut te grurit dhe miellit 41

9. Konkluzionet për transparencën e tregut te grurit, miellit dhe rekomandimet përkatese. Error! Bookmark not defined.

Tabelat, Grafikat dhe Figurat

Tabela 1. Niveli vjetor i inflacionit në Eurozonë (%), disa agregatë të selektuar 8
Tabela 2. Çmimi i disa të mirave reprezentues- Dhjetor 2021 (EUR, USD/T)..... 9
Tabela 3. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) 2021 12
Tabela 4. Çmimet mesatare të disa produkteve të selektuara (2020-2021) 13
Tabela 5. Sipërfaqja e korrur, rendimenti mesatar dhe prodhimtaria e grurit dhe plotësimi i nevojave (%), 2015-2021 në Kosovë..... 22
Tabela 6. Importi i grurit gjatë muajve, 2020 24
Tabela 7. Importi i grurit gjatë muajve, 2021 25
Tabela 8. Kompanitë importuese të grurit, 2020..... 26
Tabela 9. Kompanitë importuese të grurit, 2021..... 26
Tabela 10. Shtetet importuese, 2020 ..... **Error! Bookmark not defined.**
Tabela 11. Shtetet importuese , 2021 28
Tabela 12. Importi i miellit gjatë muajve, 2020 29
Tabela 13. Importi i miellit gjatë muajve, 2021 30
Tabela 14. Kompanitë importuese, 2020 31
Tabela 15. Kompanitë importuese, 2021 32
Tabela 16. Shtetet importuese, 2020 33
Tabela 17. Shtetet importuese , 2021 34
Tabela 18. Kompanitë eksportuese, 2020 35
Tabela 19. Shtetet eksportuese, 2020 35
Tabela 20. Kompanitë eksportuese, 2021 36
Tabela 21. Shtetet eksportuese, 2021 36
Tabela 22. Kompanite eksportuese, 2020 37
Tabela 23. Shtetet eksportuese, 2020 37
Tabela 24. Kompanitë eksportuese, 2021 38
Tabela 25. Shtetet eksportuese, 2021 38

Graf.1. Niveli vjetor i inflacionit në Kosovë, Prill 2021/ Janar 2022 (%) 11
Graf.2. Niveli vjetor i inflacionit në Shqiperi, Prill 2021/ Janar 2022 (%) 15
Graf.3. Niveli vjetor i inflacionit në Serbi, Janar-Dhjetor 2020/2021 (%) 16
Graf.4. Niveli vjetor i inflacionit në Maqedoni, Prill 2021/ Janar 2022 (%) 17
Graf.6. Niveli vjetor i inflacionit në Bosnje dhe Hercegovine, Janar-Dhjetor 2020/2021 (%)..... 18
Graf.7. Prodhuesit kryesorë të grurit në mbarë botën nga 2016/2017 deri në 2020/21 (në 1000 tonë metrikë)..... 20
Graf.8. Kurba e rritjes së çmimit të grurit..... 21
..... 21
Graf.9 . Pagesa direkte për grurë 2015-2019, në 1000 Euro (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar për grurë sipas regjionit në %, 2019 (djathtas) 23
Graf.10 . Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2020 24
Graf.11 . Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2021 25
Graf.12 . Kompanitë importuese, 2020 (%)..... **Error! Bookmark not defined.**
Graf.13 . Kompanitë importuese, 2021 (%)..... **Error! Bookmark not defined.**

Graf.14 . Shtetet importuese, 2020 (%) 27
Graf.15 . Shtetet importuese, 2021 (%) 28
Graf.16 . Lëvizja e çmimit mesatar, 2020..... 29
Graf.17 . Lëvizja e çmimit mesatar, 2021..... 30
Graf.18 . Kompanitë importuese, 2020 (%)..... **Error! Bookmark not defined.**
Graf.19 . Kompanitë importuese, 2021 (%)..... **Error! Bookmark not defined.**
Graf.20 . Shtetet importuese, 2020 (%) 33
Graf.21 . Shtetet importuese, 2021 (%) 34
Graf. 22. Struktura e grurit dhe miellit për vitin 2020 dhe 2021..... 40

Figura 1. Berza ndërkombëtare e grurit 21
Figura 2. Nivelet e referencës së përqendrimit - të matura nga Indeksi Herfindahl-Hirschman..... 39

1. Situata e përgjithshme, inflacioni dhe Çmimet në periudhën e pandemisë Covid - 19 (2020-2021)

1.1 Inflacioni në BE

Pandemia Covid-19 rezultoi në një shok të pa parashikuar në të gjitha drejtimet, ku edhe në ekonomi pati shtrëngime në kërkesën agregate dhe prodhimin. Konsumi, punësimi dhe çmimet e energjisë u zvogëluan gjatë restrikcioneve në vitin 2020 por edhe në një pjesë të vitit 2021, ku natyrshëm edhe niveli i inflacionit pësoi rënie. Në Eurozonë, niveli i ndryshimit të Indeksit të Harmonizuar i Cmimeve të Konsumit (IHCK) u zvogëlua në 0,3% në muajin Prill 2020 dhe mbeti në 0% deri në fund të vitit 2020.

Në Eurozonë në gusht të vitit 2021 niveli i inflacionit qëndroi në 3%. Problemi kryesor qëndron se oferta nuk mund ta mbërrij kërkesën dhe kjo dërgon në një disekuilibër të tregut. Mirëpo Banka Qendrore Evropiane (BQE) reagoi shpejtë duke lehtësuar masat e politikave monetare. Ndërsa qeveritë e vendeve të Eurozonës implementuan në planin e tyre pako fiskale ku përfshihen: shpenzimet qeveritare, shtyrjet e taksave dhe borxheve, dispozitat e likuiditet dhe garancionet qeveritare. Në Eurozonë, inflacioni matet me Indeksin e Harmonizuar të Cmimeve të Konsumit (IHCK) ku përfshihet shporta e të mirave dhe shërbimeve duke reflektuar modele konsumi në familjet evropiane. Përmbajtja e kësaj shporte rishikohet në fillim të çdo viti për të shikuar ndryshimet e konsumit të vitit të mëparshëm.[1]

Udhëzimet nga Komisioni Evropian u përfunduan në Dhjetor 2020 me instruksione shtesë nga Eurostat, ku i bënë thirrje institucioneve nacionale statistikore, që të rivlerësonin të mirat dhe shërbimet që u afektuan më së shumti nga kriza, si p.sh: nafta, transporti, restaurantet, hotelet. Kjo për arsye se gjatë pandemisë pati ndryshim të madh në sjelljet e konsumit, si p.sh. restaurantet dhe dyqanet jo esenciale u mbyllën, po ashtu ka pasur ulje të çmimeve të naftës si dhe transporti ajror pësoi rënie. Në përfundim, shporta me të mira dhe shërbime që përdorej për të matur inflacionin nuk mund te matej më me konsumim aktual dhe për këtë arsye duhej të bëhej një ndryshim. Eurostat i përdori këto ndryshime për të kalkuluar IHCK-në, ku ky kalkulim reprezenton modelet e vitit 2020 dhe do të përdoret në vitin 2021 për të matur inflacionin. Për shembull, mesatarja e

[1] Kerstin BERNOTH, Gökhan IDER, 2021. Inflation on the Upsëing - Just a Hiccup or a Trend Reversal After All, fq.7 https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2021/695450/IPOL_IDA(2021)695450_EN.pdf

konsumit të ushqimit dhe alkoolit u rrit për 12% në vitin 2020, mesatarja e transportit u zvogëlua me 11%, ndërsa mesatarja e hoteleve dhe restoranteve u zvogëlua me më shumë se 25%.

Duke shikuar komponentët kryesor në inflacionin e Eurozonës në vitin 2020, energjia ka nivelin më të lartë (17.4 %), e ndjekur pastaj nga të mirat industriale jo energjetikë (2,1%) , ushqimi, alkooli dhe duhani (2,1%) dhe shërbimet (1,7%).[2]

Tabela 1. Niveli vjetor i inflacionit në Eurozonë (%), disa agregatë të selektuar

	Pesha (%)	**Niveli vjetor**							**Niveli mujor**
	2021	**Dhjetor 20**	**Korrik 21**	**Gusht 21**	**Shtator 21**	**Tetor 21**	**Nëntor 21**	**Dhjetor 21**	**Dhjetor 21**
Të gjitha produktet e IHCK	**1000**	**-0.3**	**2.2**	**3**	**3.4**	**4.1**	**4.9**	**5**	**0.4**
Të gjitha produktet pa e përfshirë: energjinë	905	0.5	0.9	1.7	1.9	2	2.5	**2.8**	0.4
Ushqimi dhe alkooli	217.6	1.3	1.6	2	2	1.9	2.2	**3.2**	0.6
Energjia	95	-6.9	14.3	15.4	17.6	23.7	27.5	**25.9**	0.4
Të mirat industriale jo-energjetike	269.1	-0.5	0.7	2.6	2.1	2	2.4	**2.9**	0.1
Shërbimet	418.3	0.7	0.9	1.1	1.7	2.1	2.7	**2.4**	0.6

Burimi: Eurostat, https://ec.europa.eu/eurostat/documents/2995521/14176359/2-20012022-AP-EN.pdf/ce642dc8-1f96-fb6e-a7fc-a667762c5d37#:~:text=The%20euro%20area%20annual%20inflation,the%20rate%20was%20%2D0.3%25.

Ekonomia e Eurozonës ka operuar afër potencialit prej vitit 2018 deri kur filloi pandemia Covid-19 në fillim të vitit 2020. Mbyllja e plotë e ekonomisë së Eurozonës dhe restrikcionet quan në rënie të prodhimit dhe shfrytëzimit të kapacitetit. Si rezultat i kësaj, hendeku i prodhimit [3] u zvogëlua në -15% në gjysmën e dytë të vitit 2020. Stimulimet fiskale do të ndihmojnë në mbylljen e hendekut të prodhimit e cila u hap gjatë pandemisë Covid-19. Këto masa do të rrisin përkohësisht

[2] Kerstin BERNOTH, Gökhan IDER, 2021. Inflation on the Upsëing - Just a Hiccup or a Trend Reversal After All? fq.9

[3] Diference midis outputit aktual dhe outputit potencial

inflacionin bazë. Parashikimet sugjerojnë se hendeku i prodhimit në shtetet e Eurozonës do të mbyllet në fund të vitit 2022.[4] Impakti që do të ketë kriza e pandemisë Covid-19 varet nga kohëzgjatja e pandemisë dhe restrikcionet dhe parashikimet kanë një pasiguri të konsiderueshme. Në mes të katër ekonomive më të forta të Eurozonës, Gjermania është në listë të parë në lidhje me rritjen e inflacionit. Në rastin e kërkesës agregate, vetëm një pjesë e tepricave të kursimit nga familjet e Eurozonës gjatë kohës së pandemisë do të lirohen në formë të konsumit të mbyllur.(pent-up consumption).[5]

Si rezultat i këtij fenomeni, impakti në inflacion do të limitohet. Kjo ndodh për arsye se shumica e tepricave të kursimit janë të koncentruar në familje me të ardhura të larta, të cilat kanë nivele të ulëta të prirjes margjinale për të konsumuar.

Në një analizë nga Anketa e Parashikuesve Profesionistë (SPF) e cila është në kuadër të BQE-së tregohet se rritja e inflacionit në Eurozonë nuk ka pasur ende ndonjë impakt në pritjet e inflacionit në periudhën afatshkurtër, por që nuk përjashtohen efektet në periudhën afatmesme.

Tabela 2. Çmimi i disa të mirave reprezentuese- Dhjetor 2021 (EUR, USD/T)

Agricultural Commodity	EUROPEAN UNION 27			WORLD			
	Monthly average	Annual change	Monthly change	Monthly average		Annual change	Monthly change
CEREALS (1)	EUR/T	%	%	USD/T	EUR/T	%	%
Soft wheat	286.9	38.7%	-1.5%	379.5 (2)	335.7	41.9%	0.5%
				329.4 (3)	291.4	32.2%	-0.2%
Durum wheat	454.7	59.7%	-4.7%				
Maize	295.0 (5)	51.3%	-6.3%	266.2	235.5	34.0%	6.7%
Barley	262.8	36.1%	-0.5%	300.0	265.4	38.8%	-0.1%
MEAT							
Beef	4 415.4	21.8%	2.1%	5 954.6	5 267.7	35.3%	0.0%
Pork	1 314.1	2.2%	2.1%	1 322.5 (6)	1 170.0 (6)	15.3%	4.1%
Poultry	2 112.0	17.3%	2.2%	2 699.4	2 388.0	47.8%	17.1%
DAIRY							
Butter	5,480	62.2%	7.1%	5 833.3	5 160.4	34.5%	3.6%
Cheese	3,344	7.2%	1.2%	5 291.7	4 681.3	32.7%	5.4%
SMP	3,243	48.0%	5.9%	3 737.5	3 306.4	24.1%	4.0%
WMP	4,056	48.4%	7.5%	3 929.2	3 475.9	20.7%	-0.4%
OILSEEDS							
Soya beans				565.0 (5)	499.8	10.1%	2.2%
Rapeseed	727.2 (5)	77.0%	4.7%				
SUGAR							
White sugar	420.0 (4)	10.8%	0.7%	510.0 (5)	451.0	26.6%	-1.0%
RICE (milled)							
Japonica	980.0	36.1%	8.9%	1,200.0	1,061.6	41.8%	0.5%
Indica	710.0	1.4%	0.9%	381.2	337.2	-23.4%	1.2%

Burimi: Komisioni Evropian, https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/food-farming-fisheries/farming/documents/commodity-price-dashboard_2021-10_en.pd

[4] Kerstin BERNOTH, Gökhan IDER, 2021 Inflation on the Upsëing - Just a Hiccup or a Trend Reversal After All?, fq.12 https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2021/695450/IPOL_IDA(2021)695450_EN.pdf

[5] Kerstin BERNOTH, Gökhan IDER, 2021 Inflation on the Upsëing - Just a Hiccup or a Trend Reversal After All?, fq.8 https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2021/695450/IPOL_IDA(2021)695450_EN.pdf

2. Niveli i inflacionit në Ballkanin Perëndimor

Në vitin 2021, Ballkani Perëndimor pati një shërim të shpejtë nga recesioni Covid-19 ku ekonomitë e gjashtë vendeve e përjetuan këtë situatë. GDP-ja pritet që në fund të vitit 2021 të jetë me 5,9%, ku në vitin 2020 pësoi një rënie me 3,1%. Ky rikthim do të varet nga faktor të ndryshëm, ku përmendim: hapja vendore, faktorët eksternal të eksportit regjional. Po ashtu, niveli i varfërisë pati një trend rënës në vitin 2021, me një rënie prej 1% (gjithsej 20.3%) krahasuar me nivelin që ishte në vitin 2019. Mirëpo, ky shërim i ekonomisë nuk ka ende rrënjë të forta për ta vazhduar këtë trend. Niveli i papunësisë pati rritje në vitin 2021 në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Megjithëse bilanci fiskal u përmirësua me rritje të ekonomisë, niveli i borxhit publik ende mbetet i lartë. Si në gjithë globin, edhe në rajon niveli i inflacionit po shkon në trend të rritjes. Prandaj, politikat duhet të zhvendosin faktorët kyç të krijimit të punëve dhe transformim ekonomik. Në këtë transformim ekonomik përfshihen niveli i ulët i produktivitetit të firmave, mungesa e konkurrencës së tregut, integrimi ekonomik i limituar regjional dhe institucionet e dobëta. Edhe në Ballkanin Perëndimor, pandemia Covid-19 la një impakt negativ në të gjithë fushat dhe dërgoi shtetet në recesion të thellë. Ky recesion ndodhi për arsye të rënies edhe në kërkesën vendore dhe të huaj, ç'rregullimet në zinxhirin e ofertës, posaçërisht në fillim të pandemisë ku u vendosën masa restriktive dhe mbyllëse. Në bazë të strukturave ekonomike, ku shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat shumica janë të varura prej eksporteve dhe dobësitë fiskale, posaçërisht Shqipëria, Mali i Zi dhe Kosova priten të përjetojnë shok të fortë. [6]

Pastaj, në bazë të këtij shoku edhe GDP-ja do të pësojë rënie, ndërsa Serbia, Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina priten të kenë një recesion më të lehtë me më pak rënie të GDP-së. Sa i përket nivelit të inflacionit, Kosova është vendi i dytë me normën më të lartë me 5,7 % kurse në vend të parë qëndron Serbia me 6,6 %. Në vendin e tretë gjendet Bullgaria, me një inflacion prej 4,8% ndërsa pas këtyre vjen Mali i Zi dhe Shqipëria me 2,9% dhe respektivisht 2,4%. Përfitimet dhe humbjet nga rritja e çmimeve ndryshojnë në afat të shkurtër dhe në afat të gjatë. Në periudhën afatshkurtër, qeveria përfiton nga rritja e çmimeve sepse grumbullon më shumë taksa, që ndikojnë në uljen e borxhit publik dhe përmirësimin e deficitit fiskal. Mirëpo, në periudhën afatgjatë rritja

[6] Raporti i Rregullt Ekonomik i Ballkanit Perëndimor: Vjeshtë 2021, https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report

e çmimeve rezulton në rritje të normës së interesit dhe kjo mund të këtë një efekt negativ në borxhin publik.

2.1 Kosova

Graf.1. Niveli vjetor i inflacionit në Kosovë, Prill 2021/ Janar 2022 (%)



Burimi: ASK, https://ask.rks-gov.net/media/6571/indeksi-i-harmonizuar-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit-ih%C3%A7k-dhjetor-2021.pdf

Sipas Agjencisë Statistikore të Kosovës, norma mesatare vjetore e inflacionit për vitin 2021 ishte 3,7 %. Kryesisht kjo rritje e çmimit u pasqyrua gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë, ku kjo rritje u manifestua si pasojë e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm kryesisht nga efektet e rimëkëmbjes nga pandemia. Kosova në muajin dhjetor përjetoi nivelin më të lartë të inflacionit, me 6,9%. Indeksi i tërësishëm i Harmonizuar i Cmimeve të Konsumit (IHCK) është rritur kryesisht tek produktet e mishit, qumështit, perimet, uji dhe lëngjet, lëndët djegëse dhe shërbimet hoteliere. "Bukë dhe drithëra me 1.5 për qind, mish me 1.9 për qind, qumësht, djathë e vezë me 7.7 për qind, vajra dhe yndyra ushqimore me 28.2 për qind, perime me 19.7 për qind, sheqer, reçel, mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsira me 2.1 për qind, pijet alkoolike me 3.8 për qind, duhan me 2.7 për qind, gaz me 10.6 për qind, lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pëllet me 4.6 për qind, karburantet dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal me 26.7 për qind, shërbime për transport me 2.2 për qind, shërbime telefonike dhe të telefaksit me 20.3 për qind, pushime të organizuara turistike me 8.9 për qind, shërbime hoteliere me 2.3 dhe shërbime financiare me 6 për qind".

Tabela 3. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) 2021

Muaji	Indeksi	Ndryshimi mujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje
Janar	106.6	0.5	-0.2
Shkurt	107.4	0.7	0.7
Mars	107.8	0.4	1.2
Prill	108.2	0.3	1.9
Maj	107.9	-0.2	2.0
Qershor	107.9	0.0	2.4
Korrik	108.8	0.8	3.5
Gusht	110.1	1.2	4.7
Shtator	110.2	0.1	4.9
Tetor	111.3	1.0	5.7
Nëntor	112.7	1.2	6.9
Dhjetor	113.2	0.5	6.7
Mesatarja vjetore 2021	**109.3**		**3.4**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës - ASK

Inflacioni mujor i matur nga indeksi i Harmonizuar i Cmimeve të Konsumit ishte 1,0% në muajin tetor 2021. Indeksi i tërësishëm i Harmonizuar i Cmimeve të Konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,0% në muajin tetor 2021 krahasuar me muajin shtator 2021. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP[7]-it: buka dhe drithërat (3,9%), mishi (0,4%), qumështi, djathi dhe vezët (1,7%), vajrat dhe yndyrat ushqimore (2,9%), sheqeri, reçeli, mjaltë, çokollata dhe ëmbëlsirat (2,1%), kafja, çaji dhe kakao (3,0%), gazi (5,1%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pëllet etj. (5,8%), blerja e automjeteve (3,2%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (6.2%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 1,3 për qind në IHÇK-it. Sa i përket indeksit të çmimit të importit pati ngritje për 3.4% në TM2 2021, krahasuar me TM1 2021. Ngritjet më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinave dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (12.8%); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (11.7%); vajrat ushqyese (10.0%); produktet minerale (8.1%); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (6.4%); shtazët e gjalla, produktet e

[7] Klasifikimi Individual i Konsumit sipas qëllimit - është një klasifikim i referencës i botuar nga Divizioni i Statistikave të Kombeve të Bashkuara që ndan qëllimin e shpenzimeve të konsumit individual

shtazëve (4.3%); druri dhe artikujt e tij (4.1%); artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (3.7%); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (1.1%); produktet e industrive kimike (1.1 %); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (0.1%); mjetet e transportit (0.1 %); dhe produktet bimore (0.6%)

Në vazhdim po paraqesim krahasueshmerinë (2020-2021) e çmimeve mesatare të disa produkteve të shportës ushqimore:

Tabela 4. Çmimet mesatare të disa produkteve të selektuara (2020-2021)

Artikujt	Njësia matëse	X – 2020	IX – 2021	X - 2021
Oriz	1 kg	1.38	1.42	1.44
Miell gruri	1 kg	0.5	0.52	0.55
Bukë e bardhë	500 gr	0.35	0.36	0.38
Mish vici	1 kg	7.62	7.58	7.66
Mish Pule	1 kg	2.63	2.72	2.78
Qumësht	1 lit	0.91	0.92	0.92
Jogurt	1 lit	0.85	0.90	0.90
Vezë	30 copë	2.39	2.57	2.74
Vaj ushqimor	1 lit	1.11	1.54	1.58
Mollë	1 kg	0.73	1.14	0.8
Dardhë	1 kg	1.49	1.82	1.64
Kafe e bluar	1 kg	9.33	9.45	9.91
Caj	1 kg	7.93	7.89	7.85
Sheqer	1 kg	0.70	0.73	0.77
Domate	1 kg	0.86	1.06	0.92
Energjia elektrike	1 kg	0.06	0.06	0.06
Benzin	1 lit	0.92	1.19	1.27
Dizel	1 lit	0.90	1.16	1.23

Burimi: Agjencia Stastikore e Kosovës

Në Kosovë niveli i inflacionit ndikohet nga kërkesa e brendshme dhe lëvizjet e inflacionit në Eurozonë. Për dallim nga viti 2020 ku norma e inflacionit pati rënie e cila ndodhi për arsye të rënies së kërkesës së brendshme, në vitin 2021 rimëkëmbja e kërkesës së përgjithshme u shoqërua me rritje të çmimeve. Për shkak të pandemisë pati edhe rishpërndarje të shpenzimeve të

konsumatorëve në disa kategori. Ku për shembull gjatë kohës kur masat në fuqi ishin më kufizuese, shpenzimet e turizmit, transportit, veshmbathjeve ishin gati të papërfillshme, për dallim nga shpenzimet e shëndetësisë, ushqimit, artikujt mjekësor (maskat, dorëzat). Sipas ASK-së në vitin 2020 në sektorin e transportit dhe magazinimit është shënuar rënia më e lartë e aktivitetit ekonomik (-22.6 përqindje), pasuar nga hotelet dhe restorantet (-20.4 përqindje) kurse rritja më e larte e aktivitetit ekonomik është shënuar në sektorin e shëndetësisë dhe aktiviteteve të punës sociale (18.4 përqind). Një faktor tjetër i nivelit të inflacionit janë edhe zhvillimet që ndodhin në tregun e punës. Në bazë të statistikave për tregun e punës tregojnë se në vitin 2020 shkalla e papunësisë ishte 25.9%. Këtu ka ndikuar edhe kriza e pandemisë ku shumë biznese në sektorin privat pësuan humbje të mëdha të aktivitetit ekonomik, ku disa u detyruan edhe të mbyllnin aktivitetet e tyre biznesore. Në Kosovë, rritja e nivelit të inflacionit në vitin 2021, u shoqërua edhe me rënie të pagës mesatare, ku pastaj u zvogëlua edhe fuqia potenciale blerëse e kjo pati edhe efekt negative tek bizneset.

Sipas BQK-së kjo rritje e inflacionit pritet të shoqërohet me shtrëngim të politikës monetare dhe shtrëngim të kushteve financiare globale por sipas parashikimeve të tyre në dy vitet e ardhshme pritet që niveli i inflacionit të bie.

2.2 Shqipëria

Sipas Instat, niveli vjetor i inflacionit në Shqipëri në muajin dhjetor 2021 ishte 3.7%. Shqipëria ishte pak e prekur në fillim të pandemisë, ku u pa që menjëherë reagoi me masa mbyllëse dhe Qeveria nuk deklaroi gjendje emergjente deri në 23 qershor 2020. Vala e rritjes së çmimeve, e cila po nxitet nga kërkesat e pazakonta post-karantinë dhe problemet në transport e kanë zënë në befasi Bankën Qendrore, e cila për momentin ka deklaruar se nuk do të vënë në lëvizje mekanizmin e normës së interesit. Derisa 40% e popullsisë së Shqipërisë thuhet se do të zhyten në varfëri, kjo për arsye se përgjithësisht mbështeten tek importi, Banka e Shqipërisë thotë se rritja e çmimeve është kalimtare dhe do të ketë stabilitet në 2022. Në shtator të vitit 2021 me 9,75 euro në Shqipëri mund të blesh 1 litër vaj, 1 bukë 800 gramë, 1 kg oriz, 1 kg sheqer, 100 gramë kafe, 1 shishe ujë 1,5 litra, 10 kokrra vezë, 1 kg patate, 1 kg domate, 1 kg kastravecë. Ku të njëjtit artikuj tre muaj më parë mund ti blejë 24% më lirë. Krahasuar me fillimin e vitit, çmimet në artikujt bazë të shportës u rritën me 30% në tregjet e pakicës. Në gusht, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), apo inflacioni, i cili mat ndryshimin e çmimeve të mallrave për një grup produktesh bazë, arriti në

2.4%, niveli më i lartë ky që nga janari 2017. Që prej vitit 2012, inflacioni është luhatur afër 2%, duke arritur përkohësisht vetëm në janar 2017 në 2.8%, afër objektivit të shënjestruar të Bankës së Shqipërisë prej 3%.[8]

Graf.2. Niveli vjetor i inflacionit në Shqipëri, Prill 2021/ Janar 2022 (%)



Burimi: INSTAT

2.3 Serbia

Serbia ndodhet e para në listë nga ana e nivelit të inflacionit, respektivisht me 7.9% në Dhjetor 2021. Sipas Agjencisë Statistikore të Serbisë niveli vjetor i inflacionit u ngrit në 6.6% në Tetor 2021 nga 5,7% muajin e kaluar. Ky nivel u shënua si më i larti që prej gushtit 2013. Ku rritje më të madhe patën çmimet për ushqim dhe pije me 9.8 %, transporti me 11.75%, pijet alkoolike dhe duhani me 6.1%. Nga ana tjetër, Indeksi i çmimeve të konsumatorit (IÇK) në Serbi u rrit me 214.10 pika në tetor 2021 prej 212.10 pika sa ishte në shtator 2021.[9]

[8] INSTAT, 2021
[9] Trading Economics, 2021

Graf.3. Niveli vjetor i inflacionit në Serbi, Janar-Dhjetor 2020/2021 (%)



Burimi: Trading Economics, Agjencia e Statistikave të Serbisë

Efektet bazë në rritje të çmimeve të energjisë dhe ç'rregullimi i zinxhirit global të ofertës patën ndikim në nivelin e inflacionit. Mirëpo thuhet se ndikimi i këtyre faktorëve gradualisht do të ulet në vitin 2022. Banka Qendrore e Serbisë ka ndërmarr masa duke shtrënguar politikat monetare si pasojë e rritjes së nivelit të inflacionit, dhe se sipas parashikimeve, niveli i inflacionit pritet të jetë mesatarisht 2,4 % midis viteve 2022-26.

2.4 Maqedonia

Niveli vjetor i inflacionit në Maqedoni u ngrit në 4,9% në dhjetor 2021 prej 3,7% sa ishte në muajin shtator.[10] Ky nivel i rritjes pati presion më së shumti nga ndryshimet e transportit me 18,4%, çmimet e ushqimit dhe pijet joalkoolike me 4,6%, restorantet dhe hotelet me 8,0%.[11] Ndërsa Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (IÇK) u kalkulua me 119.55 pika në shtator, 2021. Banka Qendore e Maqedonisë tha se çmimet e shportës së konsumit priten të rriten në bazë të lëvizjeve të cmimeve të importit. Oda Ekonomike e Maqedonisë potencon që: "Çdo rritje e çmimit të energisë ndikon negativisht në biznese pasi kjo nënkupton kosto shtesë të shërbimeve operative, dhe kjo ndikon edhe në rritjen e çmimeve operative të kompanive. Kjo do të reflektohet më pas në rritjen e çmimeve të produkteve të tyre, që në fund do ta ndiejnë qytetarët pasi do të ketë rritje të çmimeve të ushqimeve.

[10] Trading Economics, 2021
[11] Trading Economics, 2021

Graf.4. Niveli vjetor i inflacionit në Maqedoni, Prill 2021/ Janar 2022 (%)



Burimi*:* Zyrja shtetërore e statistikave në Maqedoni

Nëse e vështrojmë indeksin e çmimeve në Maqedoni mund të konstatojmë se këtu kemi një inflacion të shkallës së mesme krahasuar me Serbinë si vendi me inflacionin më të lartë dhe Shqipërinë si vendi me inflacionin më të vogël në rajon. Gjithsesi edhe ky vend me raportin tregtar që kemi ne, ndikon në rrjedhat inflatore, por në masë më të vogël.

2.5 Mali i Zi

Mali i Zi në dhjetor 2021 pati nivelin vjetor të inflacionit me 4,6%. Niveli jo i lëkundur i inflacionit vjen prej kursit të fiksuar të këmbimit. Çmimet e konsumit patën rënie për veshmbathje me - 5,9%, ndërsa një rritje të restauranteve dhe hoteleve me 8,5%. Mirëpo, çmimet e transportit (8,9%) dhe çmimet e ushqimeve (4,8%) pësuan një rritje. Qeveria e Malit të Zi ka vendosur që të ketë kontroll në çmimin e bukës, prej të cilës mund të ketë efekt në disekuilibrin e ofertës dhe kërkesës në treg.[12]

[12] Trading Economics, 2021

Graf.5. Niveli vjetor i inflacionit në Malin e Zi, Prill 2021/ Janar 2022 (%)



Burimi: Agjencioni i statistikave të Malit të Zi

2.6 Bosnja dhe Hercegovina

Çmimet e konsumit në Bosnje dhe Hercegovinë u rritën 6.4 për qind nga viti në vit në dhjetor të 2021, pas një rritjeje prej 5.5 për qind në muajin e kaluar.[13] Sipas Agjencisë së Statistikave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Indeksi i Cmimeve të Konsumit u rrit në fushën e ushqimit dhe pijeve me 1,2%, veshmbathjeve me 6,9%, transporti me 0,2%, shëndeti me 0,2% dhe të mirat dhe shërbimet e tjera me 0.2%. Në linjë mujore, çmimi i produkteve u rrit me 0.8%.

Graf.6. Niveli vjetor i inflacionit në Bosnje dhe Hercegovine, Janar-Dhjetor 2020/2021 (%)



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Bosnjës dhe Hercegovinës

[13] Trading Economics, 2021

Sa i përket rritjes së çmimeve të energjisë elektrike ku është ndjerë efekti në gjithë botën, kompanitë në Bosnje dhe Hercegovinë kanë marrë njoftimin se çmimi i energjisë elektrike do të rritet me 70- 135%.[14] Nëse çmimet e reja bëhen realitet, kompanitë do të duhet të ulin prodhimin, të pushojnë punëtorët nga puna dhe të rrisin çmimin e mallrave dhe shërbimeve që shesin në treg.

3. Rendimenti i grurit-Pasqyra globale, si input që ndikon edhe në territorin e Kosovës

Kushtet ekstreme të thata, një treg i paqëndrueshëm i mallrave dhe kostot në rritje janë vetëm disa nga arsyet që po i detyrojnë prodhuesit dhe përpunuesit, të reflektojnë kostot në rritje, tek klientët/konsumatorët. Pranverën e kaluar (fillimi i pandemisë), problemet e zinxhirit të furnizimit rezultuan me mungesë të miellit në zingjirin me pakicë. Problemi nuk ishte asnjëherë mungesa e miellit apo e grurit. Përkundrazi, sfida përfshinte një kthesë të ngadaltë në paketimin e shitjes me pakicë, vonesat e transportit dhe logjistikës, mungesat e fuqisë punëtore në dyqanet ushqimore dhe blerjet nga paniku i tepërt që shkaktoi pandemia.

Lufta në Ukrainë dhe konfliktet në Detin e Zi kanë ç'rregulluar po ashtu fluksin e drithërave nga rajoni duke shkaktuar pasiguri në tregtinë globale të grurit. Ukraina që prej 24 Shkurtit, 2022 ka suspenduar të gjitha aktivitetet komerciale në port. Çmimet e eksportit të grurit janë rritur me rreth 40% deri më tani këtë vit, duke rritur njëkohësisht edhe çmimet e ushqimeve dhe duke kontribuar në një rritje të inflacionit global.[15]

Federata Ruse dhe Ukraina janë lojtar të fortë global në tregjet e agrikulturës, ku përmendim se së bashku përfaqësojnë 53% të tregut global të vajit dhe farave të luledielli dhe 27% të tregut global të grurit.[16] Bazuar në parashikimet e FAO-së për sezonin 2021/22 i bërë para fillimit të konfliktit, Ukraina pritej të eksportonte rreth 6 milionë ton grurë ndërsa Federata Ruse parashikohej të eksportonte rreth 8 milionë ton grurë gjatë kësaj periudhe. Por pas mbylljes së portit në Ukrainë dhe vështirësitë e parashikuara të shitjes në Federatën Ruse për shkak të sanksioneve ekonomike vihet në pikëpyetje nëse do të eksportohen këto të korra.

[14] Balkan Insight, 2021
[15] OECD
[16] Bazuar në të dhënat 2020 nga United Nations Comtrade Database

Impakti i këtij konflikti parashikohet të ndryshojë midis rajoneve. OECD parashikon që ekonomitë evropiane do të jenë më të goditurat për shkak të afërsisë së tyre dhe lidhjeve më të ngushta ekonomike me Ukrainën dhe Federatën Ruse.

Sipas rezultateve të një analize rapide nga UNCTAD[17], kjo situate konfirmohet se ka krijuar përkeqësim të ekonomisë botërore, duke përmendur ngritjen e çmimeve të ushqimit, naftës, paqëndrushmëria e rritur financiare, rikonfigurimet komplekse të zinxhirit global të ofertës dhe rritja e kostove tregtare.

Sipas kalkulimeve nga UNCTAD, mesatarisht, më shumë se 5% e shportës së importit të vendeve në zhvillim (Turqia, Kina, shumica e shteteve Afrikane, India) janë produkte që kanë të ngjarë të përballen me rritje të çmimit si rezultat i luftës së vazhdueshme në Ukrainë, ndërsa për vendet e zhvilluara është më pak se 1%.

Graf.7. Prodhuesit kryesorë të grurit në mbarë botën nga 2016/2017 deri në 2020/21 (në 1000 tonë metrikë)



Burimi:https://www.statista.com/statistics/237908/global-top-wheat-producing-countries/

[17] United Nations Conference on Trade and Development

Bashkimi Evropian prodhoi më shumë se 154.5 milionë tonë metrikë grurë midis 2019 dhe 2020, që përbën më shumë se një të pestën e prodhimit botëror të grurit. Për sa i përket prodhimit global të grurit sipas vendeve, Franca, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar kanë qenë vendet anëtare të BE-së prodhuese më të mëdha të grurit gjatë 10 viteve të fundit, sipas Eurostat. Në vitin 2019, Mbretëria e Bashkuar prodhoi afërsisht 16.22 milionë tonë metrikë grurë, me vlerë rreth 2.44 miliardë paund britanik. Mullinjtë nga ky rajon preferojnë përdorimin e grurit vendas në vend të grurit të importuar. Në vitin 2019, Mbretëria e Bashkuar kishte eksportuar rreth 652 mijë tonë metrikë miell në Spanjë. Kina në vendin e dytë prodhoi rreth 133 milionë tonë metrikë grurë gjatë periudhës 2019/2020. Vendi ndau 14.5 për qind të sipërfaqes së tij bujqësore për kultivimin e grurit.

Berza ndërkombëtare tregon të dhëna në rritje deri në Dhjetor 2021 për çmimin e grurit, si në vijim:

Figura 1. Berza ndërkombëtare e grurit

Graf.8. Kurba e rritjes së çmimit të grurit

Burimi: https://markets.businessinsider.com/commodities/wheat-price

Grafiku i mësipërm tregon lëvizjet e çmimit të grurit në berzën ndërkombëtarë gjatë vitit 2021 dhe fillimin e vitit 2022. Gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2021 nuk kemi rritje të konsiderueshme të çmimit të grurit në bursë. Në mesin e muajit Gusht dhe Shtator të vitit 2021 kemi një ngritje më të lartë të çmimit të grurit (afër 275.00), Ky vit (Periudha Nëntor – Dhjetor 2021) shënon rritjen më të madhe të indeksit të drithërave që nga Korriku 2008 (afër 311.00). Tremujori i parë i vitit 2022, po ashtu tregon të dhëna në rritje të çmimit në berzën ndërkombëtarë. Kërkesa e fuqishme, shtrëngimi i furnizimeve në provincat perëndimore dhe frika se prodhimi do të goditet nga moti i keqësuar mendohet që janë disa nga arsyet që forcuan çmimet si të grurit ashtu edhe të elbit në 2021.

4. Sipërfaqja, rendimenti dhe prodhimtaria e grurit për vitet 2015-2021 në Kosovë:

Tabela 5. Sipërfaqja e korrur, rendimenti mesatar dhe prodhimtaria e grurit dhe plotësimi i nevojave (%), 2015-2021 në Kosovë

Gruri	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Sipërfaqja e korrur	82,054	80,806.3	70,937.02	73,736.02	53,000	63,220.6	72,272.75
Rendimenti mesatar (kg/ha)	3,466	4,430	3,770	3,475	4,270	4,507	3,804
Prodhimtaria e përgjithshme(në mill)	284,435 mil	358,017	267,490	256,234.8	226.318	284,993.2	274,922.7
Plotësimi i nevojave	71.1%	89.5%	66.8%	64%	56.5%	71.2%	67%

Burimi: Departamenti për politika bujqësore dhe tregje

Në ekonominë tonë, prodhimtaria vendore në bujqësi nuk po arrin t'i plotësoj nevojat e konsumit, ku një pjesë e madhe e prodhimeve importohen kryesisht nga vendet fqinje. Edhe pse në vitet e fundit eksporti ka shënuar rritje, sasia e lartë e importit po ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore(Gruri), €/kg

2016 0.27 ; 2017 0.21; 2018 0.23; 2019 0.19 Ndryshimi 2019/2018 (%) Grurë – 22 % 2020:0.18;
2021 0.20 cent

Vlera për njësi e prodhimeve bujqësore të importuara(Gruri), €/kg Prodhimi

2016 0.16 ; 2017 0.17 2018 0.18; 2019 0.20 Ndryshimi 2019/2018 (%) Grurë* 11 %

Nga sipërfaqet e mbjellura ndër vite dhe prodhimi i përgjithshëm , nëse e përdorim koeficientin e konvertimit të grurit në miell(1.4) atëherë mund të fitojmë edhe konsumin e miellit për kokë banori në Kosovë.

Graf.9 . Pagesa direkte për grurë 2015-2019, në 1000 Euro (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar për grurë sipas regjionit në %, 2019 (djathtas)



Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), përpunuar nga DAESB-MBPZHR

5. Importi, struktura, vendi i origjinës, çmimi

Tabela 6. Importi i grurit gjatë muajve, 2020

Muajtë	Sasia/ Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Çmimi Mesatar
1	9,461,690.00	1,830,829.44	0.19
2	12,861,880.00	2,573,404.66	0.20
3	22,576,730.00	4,658,721.28	0.21
4	23,561,197.00	4,692,258.83	0.20
5	7,711,400.00	1,483,474.12	0.19
6	7,182,540.00	1,274,858.58	0.18
7	7,569,180.00	1,302,037.52	0.17
8	6,264,600.00	1,106,506.90	0.18
9	6,765,760.00	1,153,440.11	0.17
10	4,912,500.00	947,752.16	0.19
11	10,216,493.00	2,099,070.53	0.21
12	2,134,390.00	424,917.27	0.20
Totali:	**121,218,360.00**	**23,547,271.40**	**0.19**

Graf.10 . Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2020



Viti 2020 sipas të dhënave doganore për produktin e grurit, karakterizohet me çmime mesatare konstante dhe pa ndonjë lëvizje shqetësuese të rritjes së çmimit në import (shih graf. 9). Çmimi mesatar i këtij viti ishte 0.19 cent. Nga tabela mund të vërejmë që në muajin Shkurt, Mars, dhe Prill kompanitë kanë importuar grurë në sasi të konsiderueshme se muajt e tjerë të këtij viti.

Tabela 7. Importi i grurit gjatë muajve, 2021

Muajtë	Sasia/ Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Çmimi mesatar
1	2,363,630.00	519,769.86	0.22
2	6,001,810.00	1,338,592.20	0.22
3	4,942,420.00	1,075,291.24	0.22
4	7,255,260.00	1,488,599.46	0.21
5	8,459,540.00	1,867,511.92	0.22
6	7,657,180.00	1,651,662.71	0.22
7	9,249,490.00	1,852,272.94	0.20
8	13,490,120.00	2,770,108.30	0.21
9	13,495,590.00	2,852,096.91	0.21
10	6,511,384.00	1,662,539.29	0.26
11	5,367,760.00	1,520,305.58	0.28
12	4,157,500.00	1,191,871.00	0.29
Totali:	**88,951,684.00**	**19,790,621.41**	**0.22**

Graf.11 . Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2021

Viti 2021 sipas të dhënave doganore, krahasuar me muajin Dhjetor të vitit 2020, ku çmimi mesatar i grurit ishte 0.19 cent, në Janar 2021 importi i grurit fillon me një mesatare të rritur prej 0,3 cent pra 0.22 cent. Deri në muajin Shtator 2021 nuk kemi lëvizje shqetësuese të trajektores së çmimit mesatar. Në muajin Tetor dhe Nëntor të këtij viti, vërejmë që trajektorja e çmimit mesatar shkon në rritje, me 0.26 cent në muajin Tetor, me 0.28 cent në muajin Nëntor, dhe me 0.29 cent në muajin Dhjetor, ku edhe fillon shqetësimi dhe reflektimi i ngritjes së çmimit edhe në tregun e Kosovës(në zinxhirin me pakicë). Krahasuar periudhat e vitit 2020 dhe 2021 për importin e grurit, vërejmë që në vitin 2021 kemi ulje të importit,

për afërsisht mbi 32 milion kg. Element tjetër që vërehet nga tabela është edhe importi i lartë i sasisë së grurit në muajin Gusht dhe Shtator.

Tabela 8. Kompanitë importuese të grurit, 2020

Kompanitë importuese		Sasia/ Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Përqindja
1	(A)	(.....)	(.....)	0.19	(.....)
2	(B)	(.....)	(.....)	0.19	(.....)
3	(C)	(.....)	(.....)	0.20	(.....)
4	(Ç)	(.....)	(.....)	0.19	(.....)
5	(D)	(.....)	(.....)	0.19	(.....)
6	(DH)	(.....)	(.....)	0.19	(.....)
7	(E)	(.....)	(.....)	0.19	(.....)
8	(Ë)	(.....)	(.....)	0.21	(.....)
9	(F)	(.....)	(.....)	0.19	(.....)
10	(G)	(.....)	(.....)	0.20	(.....)
Totali:		**121,218,360.00**	**23,547,271.40**	**0.19**	**100%**

Tabela 9. Kompanitë importuese të grurit, 2021

	Kompanite importuese	Sasia / Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Perqindja
1	(A)	(.....)	(.....)	0.22	(.....)
2	(B)	(.....)	(.....)	0.23	(.....)
3	(C)	(.....)	(.....)	0.23	(.....)
4	(Ç)	(.....)	(.....)	0.23	(.....)
5	(D)	(.....)	(.....)	0.23	(.....)
6	(DH)	(.....)	(.....)	0.23	(.....)
7	(E)	(.....)	(.....)	0.22	(.....)
8	(Ë)	(.....)	(.....)	0.24	(.....)
9	(F)	(.....)	(.....)	0.25	(.....)
10	(G)	(.....)	(.....)	0.23	(.....)
11	(GJ)	(.....)	(.....)	0.23	(.....)
Totali:		**88,951,684.00**	**19,790,621.41**	**0.22**	**100%**

Tabela 10. Shtetet importuese, 2020

Shtetet	Sasia / Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Përqindja
Serbia	67,143,527.00	12,507,686.85	0.18	53%
Bullgaria	17,077,010.00	3,396,181.30	0.19	14%
Kroacia	17,246,400.00	3,328,009.43	0.19	14%
Hungaria	14,890,360.00	3,106,152.42	0.21	13%
Shqipëria	3,016,380.00	792,630.52	0.26	3%
Austria	1,057,803.00	263,173.40	0.25	1%
Maqedonia	783,680.00	152,637.48	0.19	1%
Të tjera	3,200.00	800	0.25	0%
Totali:	**121,218,360.00**	**23,547,271.40**	**0.19**	**100%**

Graf.14 . Shtetet importuese, 2020 (%)



Gruri në Kosovë importohet nga shumë shtete dhe me çmime të ndryshme. Sa i përket vitit 2020 sipas të dhënave doganore, importi me vlerën më të madhe gjatë vitit 2020 ka ardhur nga Serbia me cmim mesatar 0.18 cent/kg, që njëherit është edhe çmimi mesatar më i ulët për vitin 2020 nga të gjitha vendet tjera importuese. Në vendin e dytë pason Kroacia me 14% të tregut importues dhe me 0.19 cent/kg, pastaj Bullgaria me 14% të tregut importues me 0.19 cent/kg. Nga kjo tabelë vërejmë që aty ku çmimi mesatar është 0,18 - 0,19 cent kemi përqindje më të lartë të importit nga ato shtete.

Tabela 11. Shtetet importuese , 2021

Shtetet	Sasia/ Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Perqindja
Serbia	76,544,404.00	16,568,423.87	0.22	86%
Kroacia	5,105,260.00	1,210,819.70	0.24	6%
Hungaria	4,253,040.00	1,264,671.88	0.30	5%
Austria	3,024,580.00	742,007.56	0.25	3%
Të tjera	24,400.00	4,698.40	0.19	0%
Totali:	**88,951,684.00**	**19,790,621.41**	**0.22**	**100%**

Graf.15 . Shtetet importuese, 2021 (%)



Sa i përket vitit 2021 sipas të dhënave doganore, Serbia dominon si importuesi më i madh në shtetin tonë me rreth 86% të tregut dhe po ashtu edhe me çmimin më të lirë mesatar 0.22 cent/kg. Dominimi i Serbisë arsyetohet edhe me çmimin mesatar më të lirë prej të gjitha shteteve, njëkohësisht kjo ndërlidhet edhe me shpenzimet e transportit. Vendet tjera importuese janë Kroacia me 6% por me një çmim mesatar më të lartë 0.24 cent/kg, pastaj Hungaria me 5% dhe Austria me 3%, me çmime mesatare 0.30 cent/kg respektivisht 0.25cent/kg.

5.1 Importi i miellit gjatë viteve 2020 dhe 2021

Tabela 12. Importi i miellit gjatë muajve, 2020

Muajtë	Sasia/ Neto Kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Çmimi mesatar
1	1,721,468.70	513,661.85	0.29
2	1,637,695.19	482,835.41	0.29
3	7,460,396.30	2,463,453.45	0.33
4	5,029,869.40	1,461,851.86	0.29
5	1,153,141.70	320,936.03	0.27
6	1,486,029.12	431,384.40	0.29
7	1,640,893.14	456,998.46	0.27
8	1,792,096.96	505,993.49	0.28
9	1,664,071.62	442,552.09	0.26
10	2,207,881.92	615,537.93	0.27
11	1,974,000.40	569,451.69	0.28
12	1,834,089.76	503,626.32	0.27
Totali:	**29,601,634.21**	**8,768,282.98**	**0.29**

Graf.16 . Lëvizja e çmimit mesatar, 2020



Në Vitin 2020 sipas të dhënave doganore, sasia totale e miellit që u importua ishte 29,601,634.21 kg me çmimin total prej 8,768,282.98 milion Euro. Çmimi mesatar gjatë vitit 2020 ishte 0,29 cent/ kg. Në muajin Mars ishte import më i lartë i miellit me gjithsej (.....), pavarësisht se ky muaj pati çmimin më të lartë mesatar. Në muajin shtator cmimi mesatar ishte më i ulëti me 0,26 cent/ kg. Në figurë janë paraqitur fluktuimet e çmimit mesatar gjatë vitit 2020. Sipas kësaj, vërejmë një trajektore përafërsisht lineare, me disa lëvizje të vogla, posaçërisht gjatë muajit Mars ku çmimi mesatar ishte 0,33 cent.

Në përgjithësi luhatjet e çmimit mesatar nuk rezultuan në shqetësim të madh për produktin e miellit.

Tabela 13. Importi i miellit gjatë muajve, 2021

Muajtë	Sasia/Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar
1	1,912,333.00	541,869.37	0.28
2	1,673,932.00	490,276.52	0.29
3	1,713,484.00	505,705.28	0.30
4	1,470,403.00	438,481.22	0.30
5	1,176,550.00	348,438.84	0.30
6	1,208,650.00	370,658.24	0.31
7	1,372,932.00	416,560.07	0.30
8	1,792,192.00	554,067.94	0.31
9	1,134,450.00	364,525.67	0.32
10	1,730,038.00	567,864.25	0.33
11	1,560,399.00	560,607.56	0.36
12	1,430,654.00	535,826.93	0.37
Totali:	**18,176,017.00**	**5,694,881.89**	**0.31**

Graf.17 . Lëvizja e çmimit mesatar, 2021



Në vitin 2021 sipas të dhënave doganore, sasia totale e miellit që u importua ishte 18,176,017.00kg me çmimin total prej 5,694,881.89 milion Euro. Çmimi mesatar gjatë vitit 2021 ishte 0,31 cent/ kg me një rritje prej 0,2 cent krahasuar me vitin 2020. Në muajin Janar ishte importi më i lartë i miellit me gjithsej (.....) dhe po në këtë muaj cmimi mesatar ishte më i ulëti me 0,28 cent/ kg. Krahasuar me vitin 2020, importi për vitin 2021 ishte më i ulët për rreth 11 milion kg. Në figurë janë paraqitur fluktuimet e çmimit mesatar gjatë vitit 2021. Sipas kësaj, vërejmë një trajektore rritëse, me lëvizje lartë, posaçërisht gjatë muajit

Dhjetor theksohet rritja ku çmimi mesatar ishte afërsisht 0,37 cent/ kg. Luhatjet e çmimit mesatar janë dukshëm të mëdha në vitin 2021, me trend në rritje (graf. 16).

Tabela 14. Kompanitë importuese, 2020

	Importuesi	Sasia Neto/kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Përqindja
1	(A)	(.....)	(.....)	0.28	(.....)
2	(B)	(.....)	(.....)	0.37	(.....)
3	(C)	(.....)	(.....)	0.30	(.....)
4	(Ç)	(.....)	(.....)	0.25	(.....)
5	(D)	(.....)	(.....)	0.30	(.....)
6	(DH)	(.....)	(.....)	0.35	(.....)
7	(E)	(.....)	(.....)	0.30	(.....)
8	(Ë)	(.....)	(.....)	0.29	(.....)
9	(F)	(.....)	(.....)	0.36	(.....)
10	(G)	(.....)	(.....)	0.32	(.....)
11	Të tjera	(.....)	(.....)	0.30	(.....)
	Totali:	**29,601,634.21**	**8,768,282.98**	**0.30**	**100%**

Tabela 15. Kompanitë importuese, 2021

	Kompanite importuese	Sasia neto/ kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Përqindja
1	(A)	(.....)	(.....)	0.31	(.....)
2	(B)	(.....)	(.....)	0.27	(.....)
3	(C)	(.....)	(.....)	0.30	(.....)
4	(Ç)	(.....)	(.....)	0.29	(.....)
5	(D)	(.....)	(.....)	0.29	(.....)
6	(DH)	(.....)	(.....)	0.27	(.....)
7	(E)	(.....)	(.....)	0.36	(.....)
8	(Ë)	(.....)	(.....)	0.28	(.....)
9	(F)	(.....)	(.....)	0.26	(.....)
10	(G)	(.....)	(.....)	0.41	(.....)
11	(A)	(.....)	(.....)	0.51	(.....)
	Totali:	**18,176,017.00**	**5,694,881.89**	**0.31**	**100%**

Tabela 16. Shtetet importuese, 2020

Shtetet	Sasia /Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Perqindja
Serbia	6,359,200.00	1,573,641.17	0.25	21%
Kroacia	4,542,375.00	1,241,293.42	0.27	15%
Maqedonia	4,422,308.00	1,208,902.50	0.27	15%
Shqipëria	2,823,862.20	1,031,001.81	0.37	10%
Austria	2,954,076.00	988,283.59	0.33	10%
Hungaria	2,941,762.00	871,547.98	0.30	10%
Bullgaria	2,225,380.00	745,650.43	0.34	8%
Turqia	1,105,625.00	388,254.07	0.35	4%
Bosnja dhe Hercegovina	1,221,960.00	334,634.38	0.27	4%
Gjermania	390,630.00	138,995.89	0.36	1%
Te tjera	614,456.01	246,077.74	0.40	2%
Totali:	**29,601,634.21**	**8,768,282.98**	**0.30**	**100%**

Graf.20 . Shtetet importuese, 2020 (%)



Në vitin 2020 sipas të dhënave doganore, shtetet prej të cilave u importua më së shumti miell në Kosovë ishte Serbia me gjithsej 6,359,200 kg, me përqindje prej 21% të importit të përgjithshëm të produktit të miellit. Ndërsa Kroacia dhe Maqedonia ishin të dytat në listë me një pjesëmarrje me 15% të importit të përgjithshëm të produkteve të miellit. Cmimi mesatar më i ulëti është nga Serbia me 0,25 cent/ kg ndërsa më të lartin Shqipëria me 0,37 cent/ kg.

Tabela 17. Shtetet importuese, 2021

Shtetet	Sasia Neto/kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Perqindja
Kroacia	4,872,000.00	1,488,757.16	0.31	27%
Austria	3,549,000.00	1,218,105.48	0.34	20%
Maqedonia	3,754,692.00	1,019,056.69	0.27	21%
Hungaria	2,698,530.00	861,772.56	0.32	15%
Serbia	1,298,700.00	359,613.37	0.28	7%
Bosnja dhe Hercegovina	848,600.00	273,105.84	0.32	5%
Shqipëria	340,150.00	132,261.89	0.39	2%
Gjermania	247,890.00	106,738.95	0.43	1%
Turqia	203,500.00	71,074.18	0.35	1%
Greqia	119,270.00	50,013.17	0.42	1%
Te tjera	243,685.00	114,382.60	0.47	1%
Totali:	**18,176,017.00**	**5,694,881.89**	**0.31**	**100%**

Graf.21 . Shtetet importuese, 2021 (%)



Në vitin 2021 sipas të dhënave doganore, shtetet prej të cilave u importua më së shumti miell në Kosovë ishte Kroacia me gjithsej 4,872,000 kg, me përqindje prej 27% të importit të përgjithshëm të produkteve të miellit. Ndërsa Austria dhe Maqedonia ishin të dytat në listë me një pjesëmarrje me 20% dhe 21%, respektivisht, të importit të përgjithshëm të produkteve të miellit. Cmimi mesatar më të ulëtin e pati Serbia me 0,28 cent/kg ndërsa më të lartin e pati Shqipëria me 0,39 cent/kg.

Eksporti i Grurit:

Tabela 18. Kompanitë eksportuese, 2020

Kompanitë eksportuese	Sasia / Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Përqindja
(A)	(.....)	(.....)	0.28	(.....)
(B)	(.....)	(.....)	0.26	(.....)
(C)	(.....)	(.....)	0.26	(.....)
(Ç)	(.....)	(.....)	0.27	(.....)
TotalI:	**3,887,715.20**	**1,032,533.02**	**0.26**	**100%**

Tabela 19. Shtetet eksportuese, 2020

Shtetet eksportuese	Sasia /Neto kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Perqindja
Shqipëria	2,902,840.00	729,962.66	0.25	71%
CF(Rep. Afrikane)	369,000.00	109,980.00	0.30	11%
Maqedonia	268,659.20	81,883.16	0.31	8%
ML(Rep. Malit)	294,000.00	88,330.00	0.30	9%
Te tjera	53,216.00	22,377.20	0.29	2%
Totali:	**3,887,715.20**	**1,032,533.02**	**0.29**	**100%**

Për vitin 2020, eksporti i grurit mbërriti shifrën prej 3,887,715.20 kg grurë. Pjesën më të madhe të këtij eksporti e mbuloi kompania (.....) me mbi (.....) të eksportit të grurit.

Tabela 20. Kompanitë eksportuese, 2021

Kompanitë eksportuese	Sasia Neto/ kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Përqindja
(A)	(.....)	(.....)	0.28	(.....)
(B)	(.....)	(.....)	0.27	(.....)
(C)	(.....)	(.....)	0.27	(.....)
(Ç)	(.....)	(.....)	0.68	(.....)
Totali:	**6,570,505.64**	**1,831,679.89**	**0.27**	**100%**

Tabela 21. Shtetet eksportuese, 2021

Shtetet eksportuese	Sasia neto /kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Perqindja
Shqipëria	5,399,100.00	1,449,685.16	0.27	79%
CF(Rep. Afrikane)	526,700.00	166,956.60	0.32	9%
Maqedonia	353,345.64	111,632.93	0.32	6%
ML(Rep. Malit)	235,000.00	75,660.00	0.32	4%
Te tjera	56,360.00	27,745.20	0.30	2%
Totali:	**6,570,505.64**	**1,831,679.89**	**0.31**	**100%**

Gjatë vitit 2021 në krahasim me vitin e kaluar, kemi rritje të theksuar të eksportit të grurit nga Kosova. Totali i eksportuar arrin në shifrat 6,570,505.64 milion kg grurë, i shpërndarë në shtetet e rajonit në përgjithësi. Pjesën më të madhe të eksportit në vitin 2021 e mbuloi kompania (.....)., me mbi (.....) të grurit të eksportuar.

Eksporti i Miellit:

Tabela 22. Kompanite eksportuese, 2020

Kompanitë eksportuese	Sasia neto/kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
(A)	(.....)	(.....)	0.27	(.....)
(B)	(.....)	(.....)	0.25	(.....)
(C)	(.....)	(.....)	0.26	(.....)
(Ç)	(.....)	(.....)	0.34	(.....)
(D)	(.....)	(.....)	1.20	(.....)
Total:	**3,988,765.20**	**1,074,169.00**	**0.27**	**100%**

Tabela 23. Shtetet eksportuese, 2020

Shtetet eksportuese	Sasia Neto/kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
Shqipëria	2,902,840.00	729,963.00	0.25	68%
CF(Rep. Afrikane)	369,000.00	109,980.00	0.3	10%
ML(Rep. Malit)	294,000.00	88,330.00	0.3	8%
Të tjera	422,925.00	145,896.00	0.34	14%
Totali:	**3,988,765.20**	**1,074,169.00**	**0.27**	**100%**

Kosova në vitin 2020 ka eksportuar produktin e miellit me gjithsej 3.988.765.20 kg me shumën totale prej 1.074.169 Euro. Çmimi mesatar me të cilën Kosova eksportoi këtë produkt ishte 0.27 cent/kg. Pjesën më të madhe të eksportit të miellit e mbuloi (.....) me pjesëmarrje të eksportit të përgjithshëm me (.....).

Tabela 24. Kompanitë eksportuese, 2021

Kompanitë eksportuese	Sasia Neto/kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Cmimi mesatar	Perqindja
(A)	(.....)	(.....)	0.28	84%
(B)	(.....)	(.....)	0.27	10%
(C)	(.....)	(.....)	0.27	6%
(Ç)	(.....)	(.....)	0.68	0%
Totali:	**6,595,356.00**	**1,842,771.00**	**0.28**	**100%**

Tabela 25. Shtetet eksportuese, 2021

Shtetet eksportuese	Sasia neto/kg	Vlera totale pa tvsh (EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
Shqipëria	5,399,100.00	1,449,685.00	0.27	79%
CF(Rep. Afrikane)	526,700.00	166,957.00	0.32	9%
Maqedonia	353,346.00	111,633.00	0.32	6%
ML(Rep. Malit)	235,000.00	75,660.00	0.32	4%
Totali:	**6,595,356.00**	**1,842,771.00**	**0.28**	**100%**

Në vitin 2021 Kosova pati rritje të eksportit të produktit të miellit me gjithsej 659,365 kg me shumë totale 1,842,771 Euro dhe çmim mesatar prej 0,28 cent për kilogram. Edhe në vitin 2021 kompania (.....) dominon për nga pjesëmarrja e përgjithshme e eksportit të produktit të miellit me (.....).

Shqipëria importoi më së shumti me pjesëmarrje totale prej 79% me total prej 5,399,100 kg me çmim mesatar 0.27 cent për kilogram. Shtetet e tjera të lartpërmendura e importuan produktet e miellit me 0.32 cent për kilogram.

6. Shkalla e përqendrimit të tregut të importit tek gruri dhe mielli

Figura 2. Nivelet e referencës së përqendrimit - të matura nga Indeksi Herfindahl-Hirschman



Sipas Indeksit Hefindahl Hirschman konstatojmë se në tregun e importit të grurit, si produkt i papërpunuar, në vitin 2020 vërehet një shkallë e lartë e koncentrimit, ku niveli i indeksit është 3158. Ky nivel në bazë të niveleve të referencës së përqendrimit (0-10000) tregon se ekziston një firmë dominuese në treg, respektivisht kompania (.....)Kurse sa i përket vitit 2021, niveli i indeksit rezultoi të jetë 3844. Ku ky nivel në bazë të niveleve të referencës së përqendrimit (0-10000) tregon se ekziston një treg i lartë i përqendrimit, respektivisht kompania (.....).

Sipas Indeksit Hefindahl Hirschman konstatojmë se në tregun e importit të miellit, si produkt i gatshëm, në vitin 2020 vërehet një shkallë e lartë e koncentrimit, ku niveli i indeksit është 3392. Ky nivel në bazë të niveleve të referencës së përqendrimit (0-10000) tregon se ekziston një firmë dominuese në treg, respektivisht kompania (.....). Kurse sa i përket vitit 2021, niveli i indeksit rezultoi të jetë 5288. Ku ky nivel në bazë të niveleve të referencës së përqendrimit (0-10000) tregon se ekziston një treg i lartë i përqendrimit, respektivisht kompania (.....).

7. Struktura e tregut të grurit prodhimi vendor, importi, eksporti

	2020	2021
	Sasia – KG	
Importi i Grurit	121,218,360	88,951,684
+		
Prodhimtaria e Përgjithshme	284,993,200	274,992,700
+		
Importi i Miellit	29,601,634.21	18,176,017.00
=		
Totali i Grurit	**406,211,660**	**363,944,384**
Totali i Miellit	**29,601,634.21**	**18,176,017.00**

Graf. 22. Struktura e grurit dhe miellit për vitin 2020 dhe 2021





Nga sasia totale e importit të grurit dhe prodhimtarisë së përgjithshme të grurit në Kosovë për vitin 2020 ku u importuan 121,218,360 kg dhe u prodhuan 284,993,200 kg kemi shumën totale të grurit 406,211,560 kg, e që nëse përdorim koeficientin e konvertimit të grurit në miell (1.4) rezulton me sasinë e prodhimit të miellit për kokë banori.

2. Transparenca e tregut të grurit dhe miellit

Sipas praktikave të vendeve të BE-së por edhe te rajonit, ekziston një konsensus për tregun e grurit dhe miellit, se është e nevojshme rritja e transparencës, duke mbledhur dhe vënë në dispozicion më shumë informacion mbi sektorin e grurit, në veçanti transmetimin e çmimeve për pjesën e poshtme të zinxhirit të furnizimit ushqimor, d.m.th. industritë përpunuese, sektori i shitjes me pakicë dhe konsumatorët.

Transparenca e tregut është një element kyç për sektorin e bujqësisë pasi përmirëson fuqinë negociuese të fermerëve gjatë negociatave për kontratat duke krijuar një fushë loje më të barabartë përgjatë zinxhirit ushqimor. Përveç kësaj, transparenca e tregut ndihmon në ndërtimin e besimit midis aktorëve dhe përfaqëson një kërkesë shoqërore nga fermerët, punëtorët dhe konsumatorët. Mangësitë kryesore aktuale të identifikuara , janë vonesa kohore në raportimin e çmimit të grurit dhe mungesa e informacionit mbi transmetimin e çmimeve në pjesët e poshtme të zinxhirit të furnizimit. Një iniciativë e mundshme, për Transparencën e Tregut mund të synoj një adresim korrekt të kësaj cështje.

Sipas këndvështrimit të praktikave në BE, shkallë transparence duhet të zbatohet për fazën e përpunimit dytësor dhe shitësit me pakicë, në mënyrë që të sigurohet që konsumatorët të kenë akses në produktet e përpunuara me një çmim të drejtë dhe të përmirësojnë ekuilibrin përgjatë zinxhirit të furnizimit.

Çmimet e tregut të prodhimit vendor, çmimet e importit, njëkohsisht edhe monitorimi i importeve, eksporteve, vëllimit dhe shitjeve, do të jetë thelbësor për të kuptuar nxitësit e tregut dhe analizuar tendencat e çmimeve të grurit dhe miellit.